Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 530/01
Datë 14.12.2015

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4, 7, 10, 11, 16 dhe 17, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 14.12.2015 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për akreditimin dhe validimin e Institucionit Inicativa për Zhvillimin Bujqësisë së Kosovës, në Vushtrri për periudhën 14.12.2015 deri 14.12.2018 për të ofruar:

1.1 Teknik i blegtorisë, niveli III sipas KKK.

Akreditimi dhe validimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Të zhvillohen sipas formatit të AKK-së dhe të futen në plan programin e këtij kualifikimi këto module:

  Tipet dhe racat e gjedheve, deleve dhe dhive,

  Menaxhimi i kullosave ,

  Kërkesat ushqimore për lëndë ushqyese të gjedhet, delet dhe dhitë

- IADK të zhvilloj sipas formatit të AKK-së edhe modulet zgjedhore për këtë nivel kualifikimi

  (Afati kohor i këtyre kushteve: 01.06.2016)

1. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

- Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit;
- Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
- Raporti i Vetë-vlerësimit;
- Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1 Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi i dërgohet:

   - Institucionit Inicativa për Zhvillimin Bujqësisë së Kosovës;
   - AKK.

Nën- Kryetari i KD së AKK-së
Anton Gojani